

**PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL
PËR
MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA**

RREGULLORE E PLANIT

100

100

100

100

100

100

100





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI K.K. TASHI

ZOEDI RAMA

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Znj. BELINDA BALLUKU

PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL
PËR

MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA

RREGULLORE E PLANIT

Miruar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.1, Datë 13.01.2020

STUDIO KONSULENTE

INFRASTRUKTUR & UMWELT Professor Böhm und Partner
Gernod Dilewski, Drejtues i Ekipit

Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje
Alba Dakoli Wilson, Zëvendës Drejtuese e Ekipit





Tabela e përmbajtjes

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	5
Neni 1 Objekti	5
Neni 2 Qëllimi.....	5
Neni 3 Përkufizime.....	5
Neni 4 Shtrirja e PKS-së dhe Bashkëndimi me Instrumenta të tjerë në ZMM	10
Neni 5 Organizimi Institucional për Menaxhimin e Mbetjeve	10
Neni 6 Detyrimi për zbatim i rregullores.....	11
ZONAT E MBETJEVE, VENDNDODHJET, KLASIFIKIMI I MASAVE	12
Neni 7 Karakteristikat e ZMM.....	12
Neni 8 Kriteret për përcaktimin e kufijve të ZMM	12
Neni 9 ZMM në Territorin e Republikës së Shqipërisë.....	13
Neni 10 Klasifikimi i Masave në Menaxhimin e Mbetjeve	13
MASAT RAJONALE	15
Neni 11 Mënyra e Organizimit për Zbatimin e Masave Rajonale.....	15
Neni 12 Transferimi dhe Transporti	16
Neni 13 Trajtimi i mbetjeve të pariciklueshme, Trajtimi mekanik biologjik.....	17
Neni 14 Incinerimi dhe impantet e incinerimit.....	17
Neni 15 Depozitimi në vend depozitimet sanitare	18
MASAT VENDORE	21
Neni 16 Mënyra e organizimit për zbatimin e masave vendore.....	21
Neni 17 Fshirja e rrugëve	21
Neni 18 Grumbullimi i mbetjeve	22
Neni 19 Grumbullimi i diferencuar.....	23
Neni 20 Përpunimi i mbetjeve të riciklueshme dhe atyre organike.....	23
Neni 21 Vend depozitimet për mbetjet inerte.....	24
Neni 22 Rehabilitimi i vendgrumbullimeve të mbetjeve	25
PLANI I INVESTIMEVE DHE INSTRUMENTI I PLANIFIKIMIT	25
Neni 23 Qëllimi i Instrumenti i Planifikimit të investimeve dhe ndarja në faza	30
Neni 24 Metodologjia për caktimin e prioriteteve të investimeve	30
Neni 25 Kriteret për caktimin e prioriteteve të investimeve	30
Neni 26 Baza e të dhënave në Instrumentin i Planifikimit të investimeve dhe detyrimi për përditësim	30



Neni 27 Efektet e Tarifës dhe Përballueshmëria Financiare.....	30
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT	32
Neni 28 Ndryshimet e rregullores.....	32
Neni 29 Hyrja në fuqi	32



KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Rregullorja e PKS-së për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe kushteve të zbatueshme në lidhje me zhvillimin e sektorit të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i Rregullores është që nëpërmjet përcaktimit të rregullave të saj, të orientojë drejtimet kryesore të zhvillimit të sektorit të menaxhimit të integruar të mbetjeve në Shqipëri, të përcaktojë metodologjinë dhe teknologjinë e duhur për investimet e ardhshme në sektorin MMN, si dhe të ofrojë një plan investimi me faza për infrastrukturën vendore dhe rajonale.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Asgjësim”**, është çdo operacion, që nuk është rikuperim edhe kur operacioni ka si pasojë dytësore rikuperimin e substancave ose të energjisë.
2. **“Ambalazh”**, janë të gjitha produktet e prodhuara nga çdo lloj materiali i çdo natyre, që përdoret për mbajtjen, mbrojtjen, dorëzimin, shpërndarjen dhe prezantimin e mallrave, duke filluar që nga lëndët e para e deri tek produktet e përpunuara, nga prodhuesi të përdoruesi apo konsumatori. “Elementet e pakthyeshme”, që përdoren për të njëjtat qëllime, konsiderohen gjithashtu si ambalazhe.
3. **“Grumbullim i diferencuar”**, është grumbullimi sipas të cilit, një rrymë mbetjesh ndahet në përputhje me llojin dhe natyrën, për të bërë të mundur një trajtim specifik.



4. **“Grumbullim”**, është mbledhja, përfshirë ndarjen paraprake dhe magazinimin paraprak të mbetjeve, për transportimin e tyre në impiantet e përpunimit të mbetjeve.
5. **“Impiant bashkincinerimi”**, është çdo impiant i palëvizshëm ose i lëvizshëm, qëllimi kryesor i të cilit është krijimi i energjisë, ose prodhimi i produkteve materiale dhe:
 - a) që i përdor mbetjet si lëndë djegëse, bazë ose shtesë;
 - b) në të cilin mbetjet i nënshtrohen trajtimit termik, me qëllim asgjësimin e tyre.

Në rast se bashkincinerimi kryhet në atë mënyrë që qëllimi kryesor i impiantit nuk është krijimi i energjisë apo prodhimi i produkteve materiale, por trajtimi termik i mbetjeve, impianti do të konsiderohet si një impiant incinerimi. Ky përkufizim, mbulon vendndodhjen e impiantit dhe të gjithë impiantin, përfshirë të gjitha linjat e bashkincinerimit, vendin e pranimit të mbetjeve, të magazinimit, impiantet e paratrajtimit në vend, sistemet e furnizimit me lëndë djegëse dhe ajër, bojlerët, impiantet për trajtimin e gazrave të shkarkimit, impiantet për trajtimin ose magazinimin në vend të tepricave të mbetjeve dhe ujërave të përdorura, pajisjet e oxhaqeve dhe sistemet e kontrollit të operacioneve të incinerimit, të regjistrimit dhe të monitorimit të kushteve të incinerimit.

6. **“Impiant incinerimi”**, është çdo pajisje dhe njësi teknike, e palëvizshme ose e lëvizshme, që përdoret për trajtimin termik të mbetjeve, që e rikuperon ose jo nxehtësinë që krijohet nga djegia. Këtu përfshihet incinerimi i mbetjeve me oksidim, si dhe procese të tjera të trajtimit termik, si piroliza, gazifikimi ose proceset e plazmës, pas të cilave substancat që përftohen nga trajtimi, incinerohen. Ky përkufizim, mbulon vendndodhjen dhe të gjithë impiantin e incinerimit, përfshirë të gjitha linjat e incinerimit, vendin e pranimit të mbetjeve, të magazinimit, impiantet e paratrajtimit në vend, sistemet e furnizimit me mbetje, lëndë djegëse dhe ajër, bojlerët, impiantet për trajtimin e gazrave të shkarkimit, impiantet për trajtimin ose magazinimin në vend të tepricave të mbetjeve dhe ujërave të përdorura, pajisjet e oxhaqeve dhe sistemet e kontrollit të operacioneve të incinerimit, të regjistrimit dhe të monitorimit të kushteve të incinerimit.
7. **“Kompostimi”**, është procesi i zbërthimit mikrobiologjik i mbeturinave (biombeturinave), kryesisht me prejardhje bimore, por edhe i mbeturinave organike me prejardhje shtazore, etj.
8. **“Lendfill/vend depozitim”**, është fusha e asgjësimit të mbetjeve të ngurta mbi ose nën tokë, përfshirë:



a) një vend ku mbetjet asgjësohen brenda territorit të impiantit që i ka krijuar, siç është rasti i lëndfillit, ku krijuesi i mbetjeve i asgjëson mbetjet e veta në vendin e prodhimit;

b) një vend të përhershëm që përdoret për ruajtjen e përkohshme, zakonisht për më shumë se një vit, të mbetjeve me përjashtim të:

i) impianteve ku mbetjet shkarkohen për t'u përgatitur për t'u transportuar më pas për rikuperim, trajtim apo asgjësim diku tjetër;

ii) vendeve ku mbetjet ruhen për një periudhë kohe, jo më të gjatë se tre vjet përpara se të rikuperohen ose të trajtohen;

iii) vendet ku mbetjet ruhen për një periudhë kohe, jo më të gjatë se një vit përpara asgjësimit të tyre.

9. “Lëng kullues”, është çdo lëng që rrjedh prej mbetjeve të depozituara dhe që shkarkohet ose mbetet në lëndfill.
10. “Leje e mjedisit”, ka të njëjtin kuptim siç parashikohet në ligjin përkatës që rregullon lejet e mjedisit.
11. “Mbetje e ngurtë”, është një lëndë, një objekt ose pjesë të tij, të cilat nuk përdoren më ose që zotëruesi do t'i hedhë. Lëndët, objektet ose pjesët e tyre, vlerësohen si mbetje, për sa kohë që materialet e nxjerra prej tyre ose energjia e prodhuar nuk përfshihen në procesin e prodhimit.
12. “Mbetjet bio”, janë mbetjet e biodegradueshme nga kopshtet e shtëpive dhe parqet, mbetjet ushqimore dhe të gatimit nga shtëpitë, restorantet, kateringët dhe dyqanet e shitjes me pakicë, si dhe mbetjet e ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimeve.
13. “Mbetjet organike”, janë burimi më i mirë për prodhimin e plehut kimik dhe rritjen e bimëve. Gati 1/3 e mbetjeve që ne prodhojmë, janë mbeturina organike si: ushqim, gjethe, bar, bimë dhe lule, janë gjithçka që është biodegraduese. Koshi i mbetjeve organike pranohet mbeturinat e mëposhtme:
- Frutat dhe perimet;
 - Mishin dhe peshkun;
 - Lëvozhgat e vezëve, drithëra, bulmetra dhe ushqime të tjera të përditshme;
 - Kockat e mishit;
 - Ushqimet e ngrira dhe ambalazhet e ushqimeve që kanë cilësi biodegraduese;
 - Bimët dhe lulet;



- Të tjera.

14. **“Mbetje të rrezikshme”**, janë ato mbetje që shfaqin një ose më shumë nga vetitë e rrezikshme, përcaktuar sipas perkufizimeve në ligjin Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.
15. **“Mbetje shtëpiake”**, janë mbetjet e sektorit familjar nga komunat, bashkitë dhe qarqet apo nga nënndarjet e tyre, si dhe mbetjet e tjera që për shkak të natyrës ose përbërjes së tyre, janë të njëjta me mbetjet shtëpiake nga komunat, bashkitë dhe qarqet ose nënndarjet e tyre.
16. **“Mbetje inerte”**, janë ato mbetje që nuk i nënshtrohen ndonjë transformimi të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik. Mbetjet inerte nuk treten, nuk digjen, nuk ndërveprojnë fizikisht dhe as nuk hyjnë në reaksione kimike, nuk biodegradojnë e nuk ndikojnë negativisht në lëndë të tjera, me të cilat bien në kontakt, në mënyrë të tillë që mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit ose të dëmtojnë shëndetin e njeriut. Aftësia totale për të lëngëzuar, përmbajtja e ndotësve dhe ekotoksiciteti i lëngjeve kulluese të mbetjeve inerte, duhet të jetë e pakonsiderueshme dhe në mënyrë të veçantë, nuk duhet të verë në rrezik cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe/ose të ujërave nëntokësore.
17. **“Mbetje e lëngshme”**, është çdo mbetje në trajtë të lëngshme, përfshirë ujërat e përdorura, por përjashtuar llumrat.
18. **“Mbetje jo të rrezikshme”**, janë mbetjet që nuk mbulohen nga perkufizimi i “mbetjeve të rrezikshme”.
19. **“Mbetje të ambalazheve”**, janë të gjitha ambalazhet ose materialet e tyre që mbulohen nga perkufizimi i mbetjes në ligjin Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, me përjashtim të tepricave që mbesin nga prodhimi i tyre.
20. **“Mbetje”**, është çdo substancë ose objekt, të cilin mbajtësi e hedh, ka ndër mend ta hedhë ose i kërkohet që ta hedhë.
21. **“Menaxhim i integruar i mbetjeve”**, është grumbullimi, transportimi, rikuperimi, asgjësimi i mbetjeve dhe mbikëqyrja e këtyre operacioneve, kujdesi i mëtejshëm për vendet e asgjësimit, si dhe veprimet e ndërmarra në cilësinë e tregtarit apo agjentit.
22. **“Përgatitje për ripërdorim”**, është kontrolli, operacionet e rikuperimit, përmes pastrimit ose riparimit, me anë të të cilave produktet ose përbërësit, që janë kthyer në mbetje, përgatiten për t’u ripërdorur, pa iu nënshtuar ndonjë procesi tjetër përpunimi paraprak.



23. **“Parandalim”**, janë masat që merren para se një substancë, material ose produkt, të kthehet në mbetje, me qëllim që të pakësohet:
- a) sasia e mbetjeve, përfshirë masat për ripërdorimin e produkteve ose zgjatjen e jetës së tyre;
 - b) ndikimi i padëshirueshëm i mbetjeve në mjedis ose në shëndetin e njeriut;
 - c) përmbajtja e substancave të dëmshme në materiale dhe produkte.
24. **“Rikuperim”**, është çdo operacion, rezultati kryesor i të cilit është që:
- a) mbetjet të shërbejnë për një qëllim të dobishëm, duke zëvendësuar materiale të tjera, që do të përdreshin në rast të kundërt për të përmbushur një funksion të caktuar;
 - b) mbetjet të përgatiten për të përmbushur një funksion të caktuar në një impiant apo më gjerë.
25. **“Riciklim”**, është çdo operacion rikuperimi, me anë të të cilit materialet e mbetjeve ripërpunohen për t’u shndërruar në produkte, materiale apo substanca, për t’u përdorur, si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera. Riciklimi, përfshin ripërpunimin e materialeve organike, por nuk përfshin rikuperimin e energjisë dhe ripërpunimin që u bëhet mbetjeve, për t’i shndërruar në materiale që përdoren si lëndë djegëse apo si lëndë mbushëse.
26. **“Rajon”**, është një ose disa njësi të ndarjes administrative në Republikën e Shqipërisë.
27. **“Ripërdorim”**, është çdo operacion, me anë të të cilit produktet ose përbërësit që nuk janë mbetje përdoren përsëri për të njëjtin qëllim, për të cilin ishin krijuar.
28. **“Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”**, është optimizimi i të gjitha aktiviteteve të menaxhimit të integruar të mbetjeve, duke marrë në konsideratë grupet e interesit, elementet e menaxhimit të integruar të mbetjeve, si dhe aspektet e menaxhimit të qëndrueshëm, për të promovuar teknikat më të mira të disponueshme, ekonomikisht të zbatueshme dhe të pranueshme nga ana sociale, pa degraduar mjedisin.
29. **“Teknika më të mira të disponueshme (TMD)”**, ka të njëjtin kuptim siç parashikohet në ligjin Për Lejet e Mjedisit.
30. **“Transportim”**, është tërësia e operacioneve që përfshijnë ngarkimin, transportin dhe shkarkimin, si dhe përgatitjen, shërbimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, që përdoren për të transportuar mbetjet.



31. **“Trajtim”**, janë operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit, përfshirë përgatitjen para rikuperimit ose asgjësimit.
32. **Zona e Menaxhimit të Mbetjeve (ZMM)**, është një territor i mbuluar nga juridiksioni i një ose më shumë bashkive, e cila karakterizohet nga tipologji gjeografike e ngjashme dhe që sigurojnë një rrjet rrugor komunikimi të pandërprerë, i cili lehtëson mbledhjen dhe transportin e mbetjeve, nga pikat e grumbullimit dhe të transportimit, në destinacionet e trajtimit paraprak, rikuperimit dhe depozitimit përfundimtar të mbetjeve.
33. **Zona e Mbetjeve**, është njësia bazë për planifikimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve. Kufijtë përfundimtarë të Zonës së Mbetjeve, janë subjekt dhe përcaktohen bazuar mbi përfundimet e Planit dhe Studimit të Fizibilitetit për Zonën e Menaxhimit të Mbetjeve.

Neni 4

Shtrirja e PKS-së dhe Bashkërendimi me Instrumenta të tjerë në ZMM

Zona në studim, shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe trajtohet mbi bazën e Zonave të Menaxhimit të Mbetjeve, të përcaktuara mbi bazën e parimeve të afërsisë dhe të përballueshmërisë. Çdo bashki, bëhet pjesë e një ZMM-je, sipas përcaktimeve të këtij Plani.

Në funksion të zbatimit më të mirë të Planit Kombëtar Sektorial në Fushën e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, bashkërendohen dhe harmonizohen me PKS:

1. Plani i Përgjithshëm Kombëtar;
2. Planet e Përgjithshme Rajonale dhe/ato Vendore për çdo bashki, pjesë e zonës së planifikimit sektorial të PKS-së;
3. Politika për zbatimin e detyrimeve të parashikuara nga plane të tjera sektoriale kombëtare, për aq sa ato lidhen me fushën e mbetjeve.

Neni 5

Organizimi Institucional për Menaxhimin e Mbetjeve

Përgjegjësitë për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri ndahen midis nivelit qendror, rajonal dhe atij vendor.

Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve në nivel qendror janë:

1. Ministria përgjegjëse për mjedisin;



2. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën;
3. Ministrinë e linjës, që mbulojnë rryma specifike të mbetjeve, sipas legjislacionit në fuqi, ku përfshihen mbetjet spitalore, bujqësore, minerare, ushtarake, të rrezikshme.

Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve në nivel rajonal janë:

1. Këshilli i Qarkut, përsa i përket hartimit dhe zbatimit të politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat kombëtare;
2. Shoqëritë Rajonale të mbetjeve me kapital shtetëror.

Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve në nivel vendor janë:

1. Njësitë e Qeverisjes Vendore, sipas përcaktimeve në ligjin për vetëqeverisjen vendore, ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi, që rregullojnë menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Neni 6

Detyrimi për zbatim i rregullores

Kjo rregullore zbatohet nga:

1. Institucione publike në nivel qendror, rajonal dhe në nivel vendor;
2. Subjekte fizike dhe juridike, që operojnë në fushën e mbetjeve, pavarësisht nëse kapitali/aksionet janë shtetërore apo private;
3. Organizata jofitimprurëse;
4. Institucionet financiare ndërkombëtare, përsa i përket rregullave që do të duhet të zbatohen për projekte që financojnë pavarësisht instrumentave, kredi apo grant në fushën e mbetjeve.



KREU II

ZONAT E MBETJEVE, VENDNDODHJET, KLASIFIKIMI I MASAVE

Neni 7

Karakteristikat e ZMM

Zona e Menaxhimit të Mbetjeve ka këto karakteristika:

1. Përfaqëson një zonë, e cila është pranuar nga autoritetet qëndore përgjegjëse për planifikimin strategjik kombëtar për menaxhimin e mbetjeve;
2. Zona përmban objekte të rëndësisë zonale për trajtimin e mbetjeve, të përbërë nga një qendër për trajtimin e integruar të mbetjeve, përfshirë, një qendër për rikuperimin e materialeve të riciklueshme dhe të kompostueshme, një impiant për trajtimin përfundimtar të mbetjeve, i ndërtuar dhe që operohet në përputhje me standardet e përcaktuara në direktivën përkatëse të BE-së.
3. Mbulimi me shërbim: objektet e grumbullimit, stacionet e transferimit dhe/ose të trajtimit paraprak, janë vendosur në një distancë që merr në konsideratë shkallën e efikasitetit minimale, duke përfituar nga ekonomia e shkallës dhe siguron një mbulim eficient me shërbim, duke përfshirë:
 - Sasinë dhe përbërjen e mbetjeve për një periudhë kohore të caktuar;
 - Sasinë minimale dhe ekonominë e shkallës për objektet e trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve (mbi parimin e mbulimit të kostos dhe vetë-qëndrueshmërisë);
 - Kriteret logjistike, përfshirë kushtet fizike të rrjetit rrugor për transportin e mbetjeve, kostot e transportit kundrejt përfitimeve nga ekonomitë e shkallës për njësi më të mëdha rikuperimi dhe depozitimi;
 - Alternativat/mundësitë për t'u lidhur me objekte të tjera ekzistuese ose të projektuara, për trajtimin në një Zonë apo Zona të Menaxhimit të Mbetjeve fqinje.



Neni 8

Kriteret për përcaktimin e kufijve të ZMM

Zonat e mbetjeve, janë përcaktuar në mënyrë të tillë që, secila bashki të lidhet me një impiant rajonal për menaxhimin e mbetjeve.

Për përcaktimin e zonave të mbetjeve (zonat e mbulimit) përdoren kriteret si më poshtë:

1. Ekzistenca e impianteve për depozitimin, apo incinerimin e mbetjeve, së bashku me zonat e tyre të mbulimit;
2. Struktura hapësinore;
3. Aksesueshmëria;
4. Numri i popullësisë dhe zhvillimi;
5. Sasitë e mbetjeve në masën 100 t/d.

Neni 9

ZMM në Territorin e Republikës së Shqipërisë

Territori i Republikës së Shqipërisë, për efekt të menaxhimit të integruar të mbetjeve, ndahet në 10 ZMM. Mbështetur në kriteret e parashikuara në nenin 8 të kësaj rregulloreje, janë caktuar kufijtë për gjithsej dhjetë zona mbetjesh, sipas kufijve të përcaktuar në Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, dhe të listuara si më poshtë:

1. ZMM Berat
2. ZMM Dibër
3. ZMM Elbasan
4. ZMM Fier
5. ZMM Korçë
6. ZMM Kukës
7. ZMM Shkodër-Lezhë
8. ZMM Tiranë-Durrës
9. ZMM Vlorë Veri
10. ZMM Vlorë Jug-Gjirokastrë



Për secilën ZMM kryhet studimi i fisibilitetit përkatës, sipas zonimit indikativ, të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni. Nëse nga studimi i thelluar rezulton nevoja për rishikimin e

zonave, Agjensia Qendrore përgjegjëse për infrastrukturën e mbetjeve, në varësi të ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, bën përditësimin përkatës, sipas parashikimeve të nenit 26 të kësaj Rregulloreje.

Neni 10

Klasifikimi i Masave në Menaxhimin e Mbetjeve

Nisur nga nevoja për një sistem të integruar të menaxhimit të mbetjeve dhe ekonomia e shkallës, aktivitetet për menaxhimin e integruar të mbetjeve, klasifikohen në masa rajonale dhe masa vendore.

Masa rajonale janë:

1. Transferimi dhe transporti;
2. Trajtimi i mbetjeve të pariciklueshme, përfshi trajtimin mekanik-biologjik dhe incinerimin;
3. Depozitimi në vend depozitimet sanitare.

Masa vendore janë:

1. Fshirja e rrugëve dhe grumbullimi i mbetjeve;
2. Grumbullimi i diferencuar dhe përpunimi i mbetjeve të riciklueshme dhe atyre organike;
3. Vend depozitimet për mbetje nga ndërtimet (mbetje inerte);
4. Rehabilitimi i vendgrumbullimeve të mbetjeve.



KREU III

MASAT RAJONALE

Neni 11

Mënyra e Organizimit për Zbatimin e Masave Rajonale

Njësitë e qeverisjes vendore, bëjnë pjesë në njërën nga ZMM e nenit 9, sipas parashikimeve të Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta.

Njësitë e qeverisjes vendore, territori si i tërë apo një pjesë e tij, shtrihen brenda njërës ose më shumë nga ZMM-të e parashikuara në nenin 9 të kësaj Rregulloreje, nënshkruajnë marrëveshjet përkatëse për të krijuar shoqëritë rajonale të menaxhimit të mbetjeve, sipas procedurave të parashikuara në ligjin që rregullon vetqeverisjen vendore dhe aktet nënligjore në fuqi.

Për ZMM-të, ku janë nënshkruar kontrata koncesionare ose/dhe të partneritetit publik privat, përpara hyrjes në fuqi të Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, të cilat, lidhen tërësisht apo pjesërisht me kryerjen dhe menaxhimin e aktiviteteve rajonale, dispozitat e këtyre të fundit prevalojnë për aq kohë sa nuk janë ndryshuar me marrëveshjet përkatëse të Autoritetit Kontraktor dhe operatorit ekonomik.

Shoqëritë rajonale me kapital shtetëror, të cilat janë krijuar përpara hyrjes në fuqi të Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta dhe operojnë në një nga ZMM-të e parashikuara në nenin 9 të kësaj Rregulloreje, vijojnë të operojnë brenda kufijve të ZMM-së të përcaktuar në Plan dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.



Neni 12

Transferimi dhe Transporti

Transferimi dhe transportimi i mbetjeve, kryhet në zonat e mbulimit të vend deponimeve rajonale sanitare, të cilat kanë distanca relativisht të mëdha ndërmjet gjenerimit/grumbullimit të mbetjeve dhe asgjësimit.

Transporti i mbetjeve kryhet në kontenierë të mëdhenj të hapur ose në kontenierë të mbyllur me mbetje të ngjeshura. Ngjeshja e mbetjeve mund të bëhet ose me presa të instaluar ose me një njësi kompakte që i ngjitet gjysëm-rimorkios ose kontenierit të madh të transportueshëm. Nevoja për ngjeshjen e mbetjeve vlerësohet rast pas rasti, duke krahasuar kostot e alternativave në bazë të përbërjes së mbetjeve dhe të distancave të transportit.

Në rast se distanca e përshkruar është më shumë se 30 kilometër, atëherë parshikohet ndërtimi i stacionit të transferimit. Stacionet e transferimit të identifikuar në Planin Kombëtar Sektorial janë indikative.

Vendndodhjet e sakta të stacioneve të transferimit identifikohen në kuadër të planifikimit të detajuar të menaxhimit të mbetjeve, nëpërmjet planet vendore të menaxhimit të mbetjeve, apo dhe në studimet të fizibilitetit përkatës dhe marrin parasysh aspektet e mëposhtme:

1. Sasinë e mbetjeve që do të transportohen në vit, mundësitë për përdorim të përbashkët të stacioneve të transferimit;
2. Mundësitë e sigurimit të financimit për ndërtimin e stacionit të transferimit, si dhe prokurimin e pajisjeve të transportimit;
3. Mundësitë e sigurimit të stafit dhe fondeve për operimin dhe mirëmbajtjen e stacioneve të transferimit dhe pajisjeve të nevojshme për to;
4. Mundësitë e sigurimit të një vendndodhje të përshtatshme, mund të ketë nevojë për një proces të gjatë për përzgjedhjen dhe shpronësimin e vendndodhjes;
5. Gjendjen e rrugëve.



Neni 13

Trajtimi i mbetjeve të pariciklueshme, Trajtimi mekanik biologjik

Mbetjet e pariciklueshme përftohen me anë të ndarjes së materialeve të riciklueshme nga fraksionet e tjera të mbetjeve – impiante “të papastra” ose “të pastra” për rikuperimin e materialit (IRM).

Në impiantet për rikuperimin e materialeve (IRM) të papastra përbërësit e mbetjeve të përziera ndahen me anë të teknikës manuale të heqjes me dorë dhe/ ose ndarjes mekanike. Teknikat e skanimit dhe ndarjes përdoren për ta ndarë rrymën e mbetjeve në materiale të riciklueshme dhe në mbetje fundore të pariciklueshme që duhet të depozitohen ose të përpunohen më tej.

Trajtimi mekanik i paraprin trajtimit biologjik. Instalimet e trajtimit mekanik, para trajtimit biologjik, janë të ngjashme me instalimet e IRM dhe përbëjnë sistemet e furnizimit të depove ruajtëse, sistemet e largimit të materialeve të pafavorshme, kontaminuese, të riciklueshme, dhe LDPM-ve dhe sistemet për zvogëlimin e madhësisë së mbetjeve.

Faza e trajtimit mekanik ndiqet për largimin e materialeve inerte apo papastërtive dhe përgatitjen për një trajtim të mëtejshëm biologjik, ndarjen e materialeve të riciklueshme dhe/ose përgatitjen e lëndës djegëse me prejardhje nga mbetjet me fraksione mbetjesh me kalori të larta.

Në fazën e trajtimit biologjik, biomasa ose elementi i “kompostueshëm” përpunohet përmes tretjes anaerobike, kompostimit ose sistemit të bio-tharjes me qëllim reduktimin e masës, prodhimin e materialit të ngjashëm me kompostin, biogaz dhe/ose LDPM dhe/ose stabilizimin e mbetjeve fundore.

Neni 14

Incinerimi dhe impantet e incinerimit

Impiantet e incinerimit të cilat janë ndërtuar apo janë në proces përfundimi sipas kontratave përkatëse të koncesioneve apo të partneritetit publik privat, rregullohen në përputhje me kontratat e lidhura ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik përkatës.

Incinerimi i mbetjeve, nënkupton trajtimin termik të mbetjeve, për të ulur vëllimin dhe rrezikun e tyre, në të njëjtën kohë, për të kapur apo eliminuar substancat e dëmshme të cilat çlirohen apo mund të çlirohen, gjatë incinerimit dhe për të rikuperuar energjinë, mineralin dhe/apo përmbajtjen



kimike nga mbetjet. Përfitimi madhor i incinerimit të mbetjeve është gjurma e vogël e depozitimit të mbetjeve në mjedis për shkak të reduktimit në masë të madhe të vëllimit dhe sasisë së mbetjeve, që përfundojnë në vend depozitim. Gjithashtu, toka që nevojitet për impiantin mund të jetë sa 10 % e tokës që nevojitet për depozitimin e mbetjeve të patrajuara.

Duke marrë për bazë hierarkinë e mbetjeve, rikuperimi i energjisë termike vjen pas rikuperimit të materialit. Rikuperimi i materialit do të jetë alternativa e parapëlqyer aty ku është e mundur.

Neni 15

Depozitimi në vend depozitimet sanitare

Vend depozitimet sanitare ndërtohen sipas indikacioneve të këtij plani dhe pas studimit të fizibilitetit dhe studimeve të tjera të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

Procesi i identifikimit të vendndodhjes fillon me procesin e hartëzimit negative, pra me përjashtimin e zonave të papërshtatshme për Qendra Menaxhimi të Mbetjeve. Bazuar në legjislacionin shqiptar dhe standardet Evropiane, si dhe në përvojën me projektet e tjera, janë përpiluar kriteret për përjashtim (kriteret negative).

Kriteret e hartëzimit negativ janë:

1. QMM nuk duhet të jetë zonë në afërsi të zonave të banuara, largësi e rekomanduar 250 m;
2. QMM nuk duhet të jetë zonë në afërsi me aeroportet, largësi e rekomanduar 3 km;
3. QMM nuk duhet të jetë zonë në afërsi me zona që ndërhyjnë në infrastrukturë (rrugë, autostrada, hekurudhë);
4. QMM nuk duhet të jetë në zona të mbrojtura apo zonat e tyre buferike;
5. QMM nuk duhet të jetë në zona të identifikuarasi zona me prioritet të lartë turistik dhe monumente të trashëgimisë kulturore;
6. QMM nuk duhet të jetë në zona minerare;
7. QMM nuk duhet të jetë në zonë në afërsi me trupa ujor, largësi e rekomanduar 300 m;
8. QMM nuk duhet të jetë në tokë me pjerrësi më të madhe se 10 %.



Në secilin prej rasteve të parashikuara në kriteret e hartëzimit negative, merret mendimi i institucionit që është përgjegjës dhe mbulon fushën përkatëse.

Për projektin e ardhshëm të QMM, vendndodhja e të cilit nuk përmbush kriteret e hartëzimit negativ kryhen së paku studimet e mëposhtme:

1. Studim topografik;
2. Studim gjeologjik dhe hidro-gjeologjik (për të vlerësuar përshtatshmërinë e barrierës natyrore gjeologjike, qëndrueshmërinë e tokës dhe riskun e rrëshqitjeve);
3. Studim i florës dhe faunës (për të vlerësuar ndikimet e mundshme dhe për të hartuar masat zbutëse përkatëse);
4. Vlerësim i çështjeve sociale (për të vlerësuar kompensimin e mundshëm me pagesë, shpërnguljet dhe zhvendosjet);
5. Studime të tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Në lidhje me infrastrukturën teknike të inxhinierisë së ndërtimit kërkesat minimale janë:

1. Sistem izolues fundor për të ndaluar depërtimin e lëngut kullues në tokë dhe ujërat nëntokësore;
2. Sistem për grumbullimin dhe trajtimin e lëngut kullues;
3. Sistem degazifikimi pasiv apo aktiv për gazin e vend depozitimit, i cili duhet të përfshijë të paktën incinerimin e gazit të grumbulluar (konvertimin e metanit në dioksid karboni që është më pak i dëmshëm);
4. Izolimi i sipërfaqes për pjesët e vend depozitimit, të cilat janë mbushur plotësisht;
5. Sistem grumbullimi për ujërat që rrjedhin mbi sipërfaqen e rrugëve, për të mbrojtur vend depozitimin nga depërtimi i ujërave sipërfaqësore dhe ujërave të reshjeve.

Baza e vend depozitimit duhet të përbëhet nga:

1. Shtresë minerale $K \geq 1.0 \times 10^{-9}$ m/s; trashësia ≥ 1 m;
2. Shtresë izoluese artificiale;



3. Shtresë kullimi ≥ 0.5 m.

Në lidhje me operimin e vend depozitimit duhet të zbatohen kërkesat minimale, si më mëposhtme:

1. Plani i asgjësimit për depozitimin e përditshëm të mbetjeve;
2. Procedurat për pranimin dhe inspektimin e mbetjeve;
3. Plani për kontrollin dhe inspektimin e mbetjeve;
4. Plani për masat e sigurisë.



KREU IV

MASAT VENDORE

Neni 16

Mënyra e organizimit për zbatimin e masave vendore

Njqv, ushtrojnë funksionet në përputhje me ligjin që rregullon vetëqeverisjen vendore për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.

Mënyra e organizimit dhe ofrimi i shërbimit përzgjidhet nga secila NJQV në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe parashikimet teknike në këtë Rregullore dhe Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta.

Kontratat e lidhura me të tretë, apo dhe dokumentat e krijimit të shoqërive tregtare me kapitalin e Njqv-ve, hartohet duke marrë parasysh kontratat në fuqi brenda ZMM-ve, ku Njqv bën pjesë, si dhe funksionimin e shoqërive rajonale dhe harmonizimin me aktivitetet rajonale të parashikuara në Kreun III, të kësaj Rregulloreje.

Neni 17

Fshirja e rrugëve

Mënyrat për pastrimin e rrugëve janë fshirja në mënyrë manuale dhe fshirja në mënyrë mekanike. Elementë të rëndësishëm të pastrimit të rrugëve janë koshat publike për mbeturina.

Mënyra e fshirjes së rrugëve vendoset nga Njqv përkatëse duke konsideruar elementë si trafiku i këmbësorëve dhe ngarkesa e ndotjes që vjen si pasojë e këtij trafiku, karakteristikat e zonës, si dhe aftësinë e buxhetimit që ka Njqv.



Neni 18

Grumbullimi i mbetjeve

Mënyrat për grumbullimin e mbetjeve janë:

1. derë-më-derë (grumbullimi i mbetjeve nga cepi i trotuarit)
2. në pikat e grumbullimit kolektiv (banorët i çojnë vetë mbetjet tek kontenierët).

Të dy sistemet mund të përdoren për grumbullimin e të gjitha llojeve të mbetjeve. Mënyra e grumbullimit vendoset nga NjQV përkatëse duke konsideruar elementët si më poshtë:

1. Menaxhimin e burimeve njerëzore;
2. Planifikimi i shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve, përfshirë përcaktimin e rrugëve të grumbullimit të përditshëm;
3. Kostoja dhe aftësia buxhetore e NjQV;
4. Përzgjedhjen e pajisjeve të duhura të grumbullimit dhe përdorim të duhur të tyre;
5. Mirëmbajtjen parandaluese dhe korigjuese;
6. Menaxhimin e aseteve;
7. Veçanërisht në rastin e grumbullimit të diferencuar të materialeve të thata të riciklueshme, integrim dhe bashkëpunim me sektorin informal;
8. Vlerësimin e riskut dhe reagimi i shpejtë;
9. Marrëdhëniet publike, veçanërisht sistemi i tarifimit, aftësia paguese dhe përballueshmëria;
10. Monitorimin dhe raportimin e kostos dhe performancës së këtij shërbimi.

Në përcaktimin e kostove për menaxhimin e grumbullimit të mbetjeve NjQV mban parasysht edhe këto faktorë:

1. Cilësia, përbërja dhe dendësia e mbetjeve;
2. Numri i fraksioneve të mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar;
3. Strukturat e rrugëve dhe banimit;
4. Metoda dhe frekuenca e përzgjedhur e grumbullimit;
5. Pajisjet e përdorura;
6. Dendësia e popullsisë;



7. Distanca e transportit për tek stacionet e transferimit dhe impiantet e trajtimit dhe asgjësimit.

Neni 19

Grumbullimi i diferencuar

Mënyra e grumbullimit të diferencuar vendoset nga NjQV përkatëse, duke konsideruar elementët si më poshtë:

1. Norma e gjenerimit të mbetjeve dhe përbërja e mbetjeve;
 2. Stuktura e banimit, hapësirë e disponueshme brenda banesave/apartamenteve;
 3. Gjendja e rrugëve dhe hapësirave të disponueshme në anë të rrugëve dhe në zonat publike;
 4. Zakonet e banorëve;
 5. Teknologjitë e disponueshme dhe mundësitë e mirëmbajtjes të pajisjeve të veçanta.
1. Vlerësimin e riskut dhe reagimi i shpejtë;
 2. Marrëdhëniet publike, veçanërisht sistemi i tarifimit, aftësia paguese dhe përballueshmëria;
 3. Monitorimin dhe raportimin e kostos dhe performancës së këtij shërbimi.

Neni 20

Përpunimi i mbetjeve të riciklueshme dhe atyre organike

NjQV përcaktojnë politikat vendore mbi përpunimin e mbetjeve të riciklueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Objektivat kryesorë të riciklimit janë kursimi i burimeve dhe minimizimi i ndikimit mjedisor të mbetjeve, duke reduktuar sasinë e mbetjeve të depozituara në vend depozitim.

Riciklimi, është një element integral i sistemeve të menaxhimit efektiv të mbetjeve. Teknikat e kontrollimit dhe ndarjes, përdoren për të ndarë rrymën e mbetjeve në materiale të riciklueshme dhe në mbetje fundore të pariciklueshme që duhen depozituar ose përpunuar më tej.



Përfitimet e riciklimit janë rikuperimi i materialit dhe rrjedhimisht ruajtja e burimeve, si dhe reduktimi i sasisë së mbetjeve që çohet në vend depozitim.

NjQV përcaktojnë politikat vendore që zbatohen mbi grumbullimin e diferencuar të mbetjeve organike. Procesi biologjik stabilizon materialet organike përmes kompostimit, tretjes ose biotjarjes.

Neni 21

Vend depozitimet për mbetjet inerte

Mbetjet inerte asgjësohen në sistem menaxhimi të diferencuar, me mbetjet e tjera bashkiake. NjQV përcakton vendodhjet dhe menaxhimin e vend depozitimeve të mbetjeve inerte në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Mbetjet inerte, gjenerohen kryesisht gjatë punimeve të ndërtimit dhe të prishjes së objekteve. Në mënyrë që të ulet gjenerimi i mbetjeve inerte mbahet parasysh integrimin e këtij parimi në fazat fillestare të planifikimit të ndërtimit. Ndërtimet, duhet të projektohen dhe materialet, duhet të zgjidhen në mënyrë të tillë që strukturat të zgjasin, materialet të jenë lehtësisht të zëvendësueshëm dhe nëse hidhen, të jenë lehtësisht të riciklueshme. Gjithashtu, gjatë punimeve të ndërtimit, ripërdorimi i mjeteve ndihmëse të ndërtimit, siç janë beton-format apo materialet mbuluese, do të ndihmonin për të shmangur gjenerimin e mbetjeve të ndërtimeve dhe prishjeve (MNP).

Gjatë prishjes së ndërtesave, materialet duhet të grumbullohen në mënyrë të diferencuar, që materialet e riciklueshme, të ndahen nga materialet që nuk riciklohen dhe kërkesa për depozitim në vend depozitim të minimizohet.

Nëse vlerësohet jo fizibël ripërdorimi apo riciklimi, MNP-të inerte përdoren si mbulim për vend depozitim, material për ndërtimin e rrugëve apo si material mbushës për guroret. Nëse janë shterruar të gjitha mundësitë për ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve inerte dhe trajtimi i mëtejshëm nuk është i mundur, mbetjet fundore mund të asgjësohen në vend depozitimet për mbetjet inerte. Vend depozitimet e mbetjeve inerte pranojnë vetëm mbetje inerte.



NJQV respektojnë kontrata koncesionare apo/dhe PPP, në juridiksionin e tyre, të cilat janë në fuqi dhe parashikojnë ndëritmin dhe/ apo operimin e vend depozitimeve të mbetjeve inerte.

Neni 22

Rehabilitimi i vendgrumbullimeve të mbetjeve

NJQV hartojnë politikat dhe marrin masat në përputhje me legjislacionin në fuqi për rehabilitimin e vendgrumbullimeve ekzistuese, ose masa për mbylljen e tyre kur është rasti. NjQV marrin në konsideratë, masat e mëposhtme të përgjithshme përgatitore për koordinimin e masave përmirësuese të vendgrumbullimeve ekzistuese:

1. Përgatitja e inventarit dhe vlerësimit të riskut për vendgrumbullimet ekzistuese;
2. Zhvillimi i listës së prioriteteve për rregullimin/mbylljen (identifikimi i rasteve më urgjente);
3. Identifikimi i vendgrumbullimeve që duhen përmirësuar për të vazhduar operimin dhe i vendgrumbullimeve që duhet mbyllur;
4. Zhvillimi i stadarëve, për të cilat është rënë dakord për mbylljen e vendgrumbullimeve dhe operimin e kontrolluar;
5. Përgatitja e planeve të përmirësimit/operimit për vendgrumbullimet, ku duhet të vazhdojë operimi dhe planeve të mbylljes për vendgrumbullimet e tjera.

Metoda për rehabilitimin e vendgrumbullimeve, mbështetet në legjislacionin në fuqi dhe përzgjidhet në bazë të sasisë së mbetjeve të depozituara, densitetit, përbërjes dhe gjendjes së mbetjeve të depozituara (të dekompozuar apo të djegura tashmë), sipërfaqes dhe lartësisë së vendgrumbullimit, topografisë së vendgrumbullimit dhe rreziqeve të mundshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.



KREU V

PLANI I INVESTIMEVE DHE INSTRUMENTI I PLANIFIKIMIT

Neni 23

Qëllimi i Instrumenti i Planifikimit të investimeve dhe ndarja në faza

Qëllimi i Instrumentit për Planifikimin e Investimeve MIMN është të mbështetë vendimmarrjen në procesin e planifikimit të infrastrukturës MMN duke përcaktuar zonat e mbetjeve dhe duke identifikuar investimet rajonale dhe vendore për secilën zonë duke marrë parasysh:

1. Zhvillimin e popullsisë dhe të sasive të mbetjeve;
2. Përbërjen e mbetjeve;
3. Objektivat për rikuperimin, riciklimin dhe trajtimin e mbetjeve;
4. Përballueshmërinë financiare.

Instrumenti i planifikimit të investimeve përlllogarit në mënyrë indikative kostot e investimit dhe ato operative si për aktivitetet rajonale, ashtu edhe për aktivitetet vendore, për secilën zonë mbetjesh, duke i ndarë në tre Faza si më poshtë:

1. Faza aftashkurtër, deri në vitin 2022;
2. Faza afatmesëm, viti 2022-2027
3. Faza afatgjatë, viti 2028-2032.

Neni 24

Metodologjia për caktimin e prioriteteve të investimeve

Metodologjia për caktimin e prioriteteve për investimet bazohet në sa më poshtë:

1. Identifikimi i kriterëve për caktimin e prioriteteve për masat e investimit në menaxhimin e mbetjeve të ngurta bashkiake;
2. Identifikimi i indikatorëve dhe të dhënave burimore (të cilat janë në dispozicion ose mund të nxirren me përpjekjet e duhura) për të matur kriteret e përzgjedhura;
3. Hartimi i një metodologjie transparente dhe të kuptueshme për caktimin e prioriteteve (kombinimi i kriterëve dhe vlerësimi i rëndësisë).



Neni 25

Kriteret për caktimin e prioriteteve të investimeve

Sistemi i prioriteteve është në përputhje me drejtimin e politikave të parashtruara në dokumentat politikbërës dhe strategjik të sektorit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, si dhe mban parasysh mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e turizmit. Janë përcaktuar pesë kriteret, kundrejt të cilave vlerësohet prioriteti i një mase investimi.

Secili kriter lidhet me një objektiv dhe përshkruhet nga një ose më shumë indikatorë. Këta indikatorë matin gjendjen dhe ndryshimet në terma sasiorë, cilësorë dhe përshkrues. Kriteret që do të përdoren për planin e investimeve janë:

1. Ndikimi që ka investimi;
2. Në ç' masë kontribuon për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm;
3. Disponueshmëria e strukturave institucionale për një funksionim të qëndrueshëm;
4. Performanca dhe qëndrueshmëria financiare e shërbimeve rajonale të menaxhimit të mbetjeve;
5. Performanca dhe qëndrueshmëria financiare e shërbimeve vendore të menaxhimit të mbetjeve.

Për vlerësimin e kriterëve përdoret një sistem vlerësimi me pikë siç tregohet në tabelat më poshtë. Pikët maksimale që mund të arrihen janë 100 pikë. Projektet për të cilat ka kontrata të lidhura aplikohen automatikisht 100 pikë.

Kriteret, indikatorët dhe vlerësimi i rëndësisë, kriteret 1 – 3:



KRITERI		PIKËT
Kriteri I	Ndikimi që ka investimi	
Indikator I.1	Popullsia që përfiton nga investimi	
Matja	Nr i popullsisë në zonën e mbetjeve - deri në 150 000 (popullsia) - 150 000 deri 300 000 (popullsia) - më shumë se 300.000 (popullsia)	0 4 8
Indikator I.2	Rëndësia turistike e zonës së mbetjeve	
Matja	Përqindja e sipërfaqes në zonën e mbetjeve që njihet si e rëndësishme për turizmin - deri në 20% - 20 deri 50% - më shumë se 50%	0 4 8
Indikator I.3	Ndjeshmëria mjedisore e zonës së mbetjeve	
Matja	Përqindja e sipërfaqes në zonën e mbetjeve e përcaktuar si zonë e mbrojtur - deri në 10% - 10 deri 20% - më shumë se 20% Përqindja e sipërfaqes në zonën e mbetjeve që mbulohet nga trupa ujorë - deri në 1% - 1 deri 3% - më shumë se 3%	0 2 4 0 2 4
Indikator I.4	Vijimi i investimeve për të siguruar suksesin e projekteve madhore të investimit	
Matja	po jo	16 0
Pikët maksimale të kriterit I		40
Kriteri II	Në ç'masë kontribuon investimi për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm	
Indikator II.1	Në ç'masë kontribuon investimi për të përmirësuar grumbullimin dhe depozitim të sigurt	
Matja	fokusi kryesor në përmirësimin e grumbullimit, transportit dhe depozitim të sigurt fokusi kryesor në përmirësimin e riciklimit dhe kompostimit fokusi kryesor në impiante komplekse trajtimi	20 10 0
Indikator II.2	Ndjekja e fazave siç është rënë dakord për përmirësimin e shërbimeve të MM (Faza vijuese pas zbatimit me sukses të njëres fazë. Faza 1: Grumbullimi, transporti dhe depozitimi i sigurt i mbetjeve; Faza 2: Sistemet për riciklimin dhe kompostimin; Faza 3: Impiante të komplikuara për trajtimin e mbetjeve)	
Matja	po jo	20 0
Pikët maksimale të kriterit II		40
Kriteri III	Disponueshmëria e strukturave institucionale për funksionim të qëndrueshëm	
Indikator III.1	Nëse ka marrëveshje për bashkëpunim ndërbashkiak, që përcaktojnë përmbajtjen dhe mënyrat e bashkëpunimit për menaxhimin rajonal të mbetjeve	
Matja	po jo	10 0
Indikator III.2	Nëse ka struktura administrative për ofrimin e shërbimeve rajonale të menaxhimit të mbetjeve	
Matja	po jo	10 0
Pikët maksimale të kriterit III		20
Pikët maksimale të kriterëve I - III		100



Kriteret, indikatorët dhe vlerësimi i rëndësisë, kriteret 4 dhe 5:

KRITERI		PIKË
Kriteri IV	Performanca dhe qëndrueshmëria financiare e shërbimeve rajonale të menaxhimit të mbetjeve	
Indikator IV.1	Funksionimi sipas standardeve ligjore	
Matja	po jo	20 0
Indikator IV.2	Mbulimi i kostos	
Matja	Përqindja e kostove që mbulohet nga tarifa në hyrje të vend depozitimit kostot operative nuk mbulohen mbulimi i plotë i kostove operative mbulimi i plotë i kostove operative dhe të ri-investimit	0 10 20
Pikët maksimale të kriterit IV		40
Kriteri V	Performanca dhe qëndrueshmëria financiare e shërbimeve vendore të MM	
Indikator V.1	Mbulimi me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve	
Matja	Përqindja e popullsisë në zonën e mbetjeve/ bashki që marrin shërbimin e grumbullimit të mbetjeve - deri në 60% - 60 - 90% - më shumë se 90%	0 10 20
Indikator V.2	Mbulimi me grumbullim të diferencuar të mbetjeve	
Matja	Përqindja e popullsisë që ka qasje në skemat e grumbullimit të diferencuar - nuk ka grumbullim të diferencuar - deri në 20% të zonës së shërbimit - më shumë se 20% të zonës së shërbimit	0 10 20
Indikator V.3	Mbulimi i kostos nga tarifat	
Matja	Përqindja e kostos së shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve që mbulohet nga tarifat - kostot operative nuk mbulohen - mbulimi i plotë i kostove operative - mbulimi i plotë i kostove operative dhe të ri-investimit	0 10 20
Pikët maksimale të kriterit V		60
Pikët maksimale të kriterit IV - V		100

Neni 26

Baza e të dhënave në Instrumentin i Planifikimit të investimeve dhe detyrimi për përditësim

Planet për investimet rajonale janë hartuar për secilën zonë mbetjesh me anë të përdorimit të ISËM-IPT¹. Në këtë instrument, janë përcaktuar zonat e mbetjeve dhe për secilën zonë dhe secilën bashki janë përcaktuar elementët e MIMN në situatën aktuale dhe në të ardhmen.

Baza e të dhënave e krijuar nga ky instrument është e lidhur me bazën e të dhënave GIS në mënyrë që të paraqesë në harta ndëraktive impiantet e planifikuara dhe ekzistuese duke përfshirë kapacitetet e tyre dhe kostot që nevojiten për investimin dhe funksionimin. Produktet e këtij instrumenti janë:

1. Prezantimi i nevojave për investime për secilën zonë mbetjesh për tri fazat e planifikimit,

¹ Instrumenti bazohet në një dokument MS Excel 2010 (Version 14).



2. Llogaritja e kostove të investimit dhe atyre operative për secilën zonë mbetjesh (impiante rajonale) dhe secilën bashki (komponentët vendorë MMN),
3. Llogaritja e kostove specifike për ton mbetje dhe për familje,
4. Prezantimi i objektivave që synohen të arrihen në drejtim të rikuperimit, riciklimit dhe depozitimit të mbetjeve në vend depozitime,
5. Lidhja me bazën e të dhënave GIS – paraqitje vizuale e masave të investimit në harta

Të dhënat në Instrumentin e Planifikimit janë në formën e fotografimeve të çastit bazuar në informacionin e disponueshëm aktualisht.

Përditësimi i Instrumentit dhe i kriterëve për caktimin e prioriteteve të investimeve kryhet nga Agjencia Qendrore përgjegjëse për infrastrukturën e mbetjeve, në varësi të ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, cdo vit.

Cdo NjQV, si dhe cdo subjekt shtetëror në nivel qendror apo vendor, si dhe cdo subjekt privat, është i detyruar t'i raportojë agjencisë, me kërkesë të kësaj të fundit, të dhënat e kërkuara, brenda 10 ditëve nga marrja e shkresës.

Neni 27

Efektet e Tarifës dhe Përbalueshmëria Financiare

Plani Kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve mbështet mbi parimin e rikuperimit të kostove dhe mbi parimin ndotësi paguan. Përcaktimi i tarifave është përgjegjësi e NjQV. Për vendosjen e tarifave duhet të merren parasysh parimet e mëposhtme:

1. Barazi horizontale: çdokush paguan për nivelin e shërbimit dhe frekuencën e grumbullimit të mbetjeve në një zonë të caktuar shërbimi;
2. Barazi vertikale: struktura e tarifës duhet të marrë parasysh kontekstin social dhe të pasqyrojë potencialin e ndryshëm financiar të gjeneruesve të mbetjeve;
3. Transparencë dhe përbalueshmëri: tarifat duhet të pasqyrojnë kostot dhe përbalueshmërinë e tyre prej qytetarëve, të cilët duhet të jenë të informuar në mënyrë transparente rreth përlllogaritjes së kostove dhe tarifave;
4. Efektshmëri: sistemi i tarifimit duhet të jetë i thjeshtë dhe të përshtatet me të dhënat dhe informacionin e disponueshëm lidhur me grupet e ndryshme të paguesve potencialë të tarifës, si edhe sa më lirë që të jetë e mundur për koston e zbatimit për bashkinë.



Për përcaktimin e tarifës maksimale të përballueshme, NjQV marrin parasysh që tarifa nuk duhet të kalojë 1% e shpenzimeve vjetore për familje, sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT.



KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 28

Ndryshimet e rregullores

Ndryshimet e kësaj Rregulloreje dhe të vetë Dokumentit të PKS-së, bëhen sipas procedurave të përcaktuara nga legjislacioni kombëtar në fuqi.

Neni 29

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore dhe vetë Dokumenti i Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, hyn në fuqi me miratimin nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe botimin në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

